



## INTERES PËR CERTIFIKIMET

Certifikimet për sigurinë ushqimore dhe sigurinë e informacionit vazhdojnë të shënojnë rritje marramendëse

Nga Bashkim MUÇA\*

**P**ikat kryesore të Anketimit të ISO mbi Certifikimet - 2009 tregojnë se zbatimi i standardit ISO 9001, pika globale e referimit për menaxhimin e cilësisë, ka kapur shifrën e një milion certifikimeve të kryera me sukses, ndërsa certifikimet për ISO 22000:2005 - sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore dhe ato të ISO / IEC 27001: 2005 - sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit, kanë shënuar rritje verbuese. Komentet e ISO në prezantimin e rezultateve të anketimit, tregojnë se rritja prej 8% në vitin 2009 për certifikatat e ISO 9001, krahasuar me rritjen prej 3% gjatë 2008-s, "konfirmon rëndësinë e zbatimit të standardit ISO 9001 në zinxhirët e furnizimit global dhe se ka shërbyer si model pionier, sipas të cilit janë hartuar dhe zhvilluar më tej standardet e tjera të sistemit të menaxhimit". Zinxhirët e furnizimit të sigurisë ushqimore janë përparësi globale. Certifikimet për ISO 22000:2005 kapën shifrën e të paktën 13 881 certifikatave në 127 shtete dhe ekonomi - një rritje prej 69%. Rëndësia e madhe që organizatat i japin sigurisë së informacionit demonstron me rritjen prej 40% në certifikimet sipas standardit ISO/IEC 27001, me një shifër prej 12 934 në 117 vende të botës. Sekretari i përgjithshëm i ISO, Rob Steele, komenton: "Çdo vit, rezultatet e anketimit më të fundit të ISO janë një ngjarje e pritur me padurim dhe konsiderohen si burimi kryesor i informacionit për rëndësinë dhe rolin e zbatimit të standardeve të sistemit të menaxhimit të ISO-s në ekonominë globale. Për të parën herë, botimi i ri është duke u publikuar në

një CD-ROM, i cili përmban materialet e anketimit në Excel që nga anketimi i parë në 1993 deri në fund të vitit 2009. Vënia në dispozicion e këtyre të dhënave në një CD të vetme do të lehtësojë krahasimin dhe e bën anketimin një mjet edhe më të dobishëm në duart e biznesit".

### SHIFRAT NGA 1993 DERI NË 2009

Për herë të parë, ISO po e vë anketimin për periudhën 1993-2009 në dispozicion të kujtdo që është i interesuar, në një CD-ROM në Excel, e cila lejon të bëhen krahasime që nga anketimi i parë. Të dhënat për disa nga standardet më të kërkuara lidhur me certifikimet e sistemeve të menaxhimit paraqiten si më poshtë:

### ISO 9001

ISO 9001 (të gjitha certifikimet e kryera sipas standardeve ISO 9001:2000 dhe ISO 9001:2008) i cili jep kërkesat për sistemet e menaxhimit të cilësisë, është standardi që zbatohet globalisht për të ofruar siguri në lidhje me aftësinë në përmbushjen e kërkesave të cilësisë dhe për të rritur kënaqësinë e konsumatorit në marrëdhëniet klient-furnizues. Deri në fund të dhjetorit 2009, të paktën 1 064 785 certifikata të ISO 9001 (versionet e ISO 9001:2000 dhe ISO 9001:2008) u lëshuan në 178 shtete dhe ekonomi të ndryshme të globit. Në total, 2009 paraqet një rritje prej 81 953 (+ 8%) më shumë se 2008, ku numri i përgjithshëm i certifikatave të lëshuara ishte 982 832 në 176 shtete dhe ekonomi të ndryshme të globit.

### ISO 14001:2004

ISO 14001:2004, i cili jep kërkesat për sistemet e menaxhimit të mjedisit, ruan

rëndësinë e tij globale për organizatat që dëshirojnë të operojnë në një mënyrë të qëndrueshme për mjedisin. Deri në fund të dhjetorit 2009, të paktën 223 149 certifikata të ISO 14001:2004 u lëshuan në 159 shtete dhe ekonomi të ndryshme të globit. Rritja vjetore është pothuajse në të njëjtin nivel si në 2008-n. Shënohen 34 334 certifikata në vitin 2009, krahasuar me 34 242 në vitin 2008, ku në total ishte 188 815 në 155 shtete dhe ekonomi të ndryshme të globit.

### ISO/TS 16949

#### (SPECIFIKIME TEKNIKE TË ISO)

ISO / TS 16949 (të gjitha certifikimet e kryera sipas versioneve të vitit 2002 dhe 2009) jep kërkesat për zbatimin e ISO 9001:2000/8 nga furnizuesit në sektorin e automobilave. Deri në fund të dhjetorit 2009, të paktën 41 240 ISO / TS 16949:2002 certifikata u lëshuan në 83 shtete dhe ekonomi.

### ISO 13485:2003

ISO 13485:2003 jep kërkesat e menaxhimit të cilësisë për sektorin e pajisjeve mjekësore për qëllime të zbatimit të rregulloreve në fuqi. Deri në fund të dhjetorit 2009, të paktën 16 424 ISO 13485:2003 certifikata u lëshuan në 90 vende dhe ekonomi. 2009 në total paraqet një rritje prej 3 190 (+ 24%) krahasuar me 2008 ku numri i përgjithshëm ishte 13 234 në 88 shtete dhe ekonomi.

### ISO/IEC 27001:2005

ISO / IEC 27001:2005 jep kërkesat për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Në fund të 2009-s, të paktën 12 934 ISO / IEC 27001:2005 certifikata u lëshuan në 117 vende dhe ekonomi. 2009 në total paraqet një rritje prej 3 688 (+ 40%) mbi 2008 ku numri i përgjithshëm ishte 9 246 në 82 shtete dhe ekonomi.

### ISO 22000:2005

ISO 22000:2005 jep kërkesat për sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore. Deri në fund të dhjetorit 2009, të paktën 13 881 ISO 22000:2005 certifikata u lëshuan në 127 shtete dhe ekonomi. 2009 në total paraqet një rritje prej 5 675 (+ 69%) mbi 2008 ku numri i përgjithshëm ishte 8 206 në 112 shtete dhe ekonomi.

### ANKETIMI NË NJË CD-ROM

ISO vë në dispozicion falas në website gjetjet kryesore të anketimit të ISO. Më shumë informacion, duke përfshirë edhe dëshitime të sektorit të industrisë, mund të gjenden në CD-ROM - Anketimi i ISO për certifikimet - 2009. Ky CD-ROM i vihet në dispozicion, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS) si Organi Kombëtar i anëtarësuar në ISO kujtdo që është i interesuar ta ketë për informacion të detajuar. ■

\*Autori është Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit